

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 5786/Prot.

Tiranë, më 20.12.2023

VENDIM

Nr. 74, datë 20. 12. 2023

PËR

**“MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE
MASTER EKZEKUTIV NË “KIRURGJI PEDIATRIKE”, PRANË FAKULTETIT TË
MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; neni 3, pika 4, shkronja “c”, neni 35, neni 77, pikat 1 dhe 2; në Statutin e UMT-së, neni 98, pika 4; në Udhëzimin e MAS nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 3, shkronja “b”; në Relacionin e DAAK pranë Rektoratit të UMT-së, si dhe në Vendimin nr. 127, datë 11.12.2023 të Senatit Akademik të UMT-së, “Për miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në “Kirurgji Pediatrike” pranë Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në mbledhjen e datës 20.12.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të tretë të studimeve, Master Ekzekutiv në “Kirurgji Pediatrike” pranë Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Efektet financiare të hapjes së programit të ciklit të tretë të studimeve Master Ekzekutiv në “Kirurgji Pediatrike”, përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.
3. Tarifa e shkollimit është në vlerën 115,000 (njëqindpesëmbëdhjetë mijë) lekë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UMT-së dhe Fakulteti i Mjekësisë në UMT.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË
VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ